


REPUBLIKA E KOSOVËS
KOSOVA
VENDIMI ESHTË I PLOTËQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
MITROVICË - MITROVICA
Me
Data: 03.04.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.89/2017

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS si kontestimore e përbërë nga kolegji gjyqësorë: Naim Mehollli kryetar dhe anëtarëve porotë: Sadik Lushtaku dhe Sebiha Smakiq në çështjen juridike të propozuesit: _____ nga _____ të cilën e përfaqëson Av. _____ dhe propozueses _____ e vajzërisë _____ nga _____, për shkak të zgjidhjes së martesës, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 03.04.2017 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- **MARTESA** ne mes te propozuesit _____ i lindur me _____ ne _____, nga i ati _____, e ëma _____ dhe propozueses _____ e vajzërisë _____, e lindur me dt. _____ ne _____, nga i ati _____, e ëma _____. Martesa ishte e lidhur me dt. 10.05.2016 ne zyrën e gjendjes civile ne _____ me numër rendor _____, Reference martesore _____ RM/**ZGJIDHET** për shkak te çrregullimeve te marrëdhënieve bashkëshortore ne baze te nenit 68 dhe 69 te Ligjit për Familje te Kosovës, sipas propozimit te përbashkët te bashkëshorteve.
- Secila pale i barte shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Procedura në këtë çështje në fillim u iniciua me padinë e parashtruar nga ana e te autorizuarit te paditësit, mirëpo meqenëse padinë nuk e kundërshtoi në seancë e paditura, padia e paditësit ne kuptim te nenit 68 par.4 u trajtua si propozim i përbashkët i bashkëshortëve për zgjidhje të martesës me marrëveshje.

Gjykata me datë: 03.04.2017 ka caktuar seancën gjyqësore në këtë çështje.

I autorizuari i propozuesit deklaroi: se e njoftoi gjykatën se me te paditurën, paditësi ka arritur marrëveshje qe kjo martës te zgjidhet me propozim te përbashkët andaj i propozoi gjykatës qe padia e paditësit te konsiderohet

Propozuesja deklaroi se nuk e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë, propozoi gjykatës që padia e padia e paditësit të konsiderohet propozim i përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i propozuesit deklaroi : mbetëm pran propozimit së parashtruar, meqenëse nuk është kundërshtuar padia i propozoj Gjykatës që këtë martës ta zgjedh sipas propozimit të përbashkët të bashkëshorteve. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Në fjalën përfundimtare propozuesja deklaroi se mbetëm në tersi sikurse në thëniet e mëhershme. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Në procedurën e provave gjykata administroi këto prova: certifikata martesore e dt.21.02.2017, kopja e dokumenteve identifikues për palën paditëse.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe të gjitha së bashku dhe nga të njëjtat vërtetoi këto fakte:

Nuk është kontestues fakti se propozuesit kanë lidhur martesë në mes tyre me datë: 10.05.2016, këtë fakt gjykata e vërteton në bazë të certifikatës së martesës.

Meqenëse propozimi për shkurorëzim është bërë me marrëveshje, siç e parashohin edhe dispozitat ligjore gjykata nuk e pa të arsyeshme të hetoi rreth shkaqeve të shkurorëzimit, pasi si shkak i veçantë ceket edhe shkurorëzimi me marrëveshje.


Sa i përket të drejtës materiale gjykata u bazua në nenet: 68, 69 dhe 84 të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata vendimin e mori konform nenit 450 të LPK-së.

Aktgjykimi bazohet në nenin 143, par.1 të LPK .

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.89/2017 të dt.03.04.2017

KRYETARI I KOLEGJIT – GJYQTARI
Naim Mehulli



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Ky aktgjykim bëhet i plotfuqishëm me datë: 03.04.2017 pasi palët ndërgjyqëse kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë.